

ISMAIL SYLA
LIBRI I TIRANIVE
POEZI

BOTIMET TOENA

ISMAIL SYLA

Libri i tiranive

poezi

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2016

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktor: Kujtim Dashi

Korrektore letrare: Majlinda Bami

Përkujdesja grafike: Elida Stafa

Kopertina: Albana Kuraj Gega

ISBN: 978-9928-205-47-6

© Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi i materialeve që përmban ky libër me asnjë mjet apo formë, as me fotokopje, as pjesërisht, pa lejen me shkrim të Botimeve Toena.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116; 22 58 893

Fax: +355 4 22 40 117

E-mail: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

*Gruas sime, Elbasanes dhe fëmijëve tanë:
Taulantit, Pleuratit, Orgesit, Trimit dhe Molosit*

Parathënie

Pasi i shkon deri në fund vëllimit poetik “Libri i tiranive” të Ismail Sylës, të pushton vetvetiu një ndjenjë keqardhjeje se si është e mundur, që në dy republika shqiptare me një kufi formal e paradoks mosbashkimi gjeopolitik të tyre, të kemi këtë nivel ende të pakënaqshëm të njohjes e të shkëmbimeve reciproke të vlerave të mirëfillta letrare e artistike në mes të njëri-tjetrit dhe, në të njëjtën kohë, pushtohesh nga gëzimi e kënaqësia se një libër i tillë, me siguri, do të kapërcejë këtë “kufi” hëpërhë shqiptaro-shqiptar, duke u botuar nga “Toena”.

Libri i tiranive!

Autori ka pranëvënë si një “urdhër” superior e me një renditje të përkryer jetësore, korelative e perspektive para gjërave më të shenjta të njeriut, si Lirisë, Zgjimit, Bukurisë, Lisit, apo Proverbave shqipe, Robërisë, Vetmisë, Kaosit etj., fjalën prozaike “tirani” ose “gjithëpushteshmëri”, që përdoret në leksikun e zakonshëm e aktiv, si sundim absolut e despotik, si të ishin bash Zotat tanë.

Me “tiranitë” e sipërpërmendura, autori i njohur Ismail Sylë ka krijuar sistemin e tij poetiko-koordinativ të mirëmenduar si një tabelë poetike “mendelejeviane”, për ta shijuar bukurinë e shprehjes poetike origjinale e metaforike të tij dhe, në aspektin më utilitar, për ta orientuar artistikisht e estetikisht lexuesin shqiptar drejt tiranive a superioriteteve reale e thelbësore të jetës së tij

të trazuar historikisht, që ushqehen në filozofinë e pedagogjinë popullore si dhe në përvojat vetjake.

Këtë vëllim poetik do ta quaja si një enciklopedi poetike të botës shqiptare e shkruar me një frymëzim e me plot gjetje e imazhe poetike të fuqishme, mençurore e humane, me një strukturë kompozicionale polifonike të mirëthurrur e të mbajtur gjatë, siç duket në mendjen e tij, si kryemotiv, si kryekëngë e vademekum vlerash shpirtërore, që zbulohen ca nga ca si një bukuri nën duvak. Fakti që nën çdo poezi vihet, madje me saktësi e detaje, vendi dhe kohëlidja e çdo poezie, si një lloj biografie a konturi ekzakt poetik dëshmon preokupimin e vazhdueshëm të autorit që është gjithkund i pranishëm dhe i ngarkuar në kurriz bletërisht me këto tirani, që formësojnë konstitucionin shpirtëror të popullit tonë apo duan ta përsosin atë, të djeshmen, të sotmen e të ardhshmen, si realitet, dëshirë, ëndërr a përjetim konkret i çastit apo i ditës, prej nga burojnë vetvetishëm në vargjet e tij poetike, të cilat e tregojnë aq sa një bard, që udhëton i menduar me fjalën e mençur dhe vargun, aq dhe një lirik i ndjeshëm, projektori metaforik i të cilit ka arritur të depërtojë deri në pejzat më të holla të shpirtit njerëzor.

Gjithëpushtetshmëritë apo tiranitë e Ismail Sylës nisin nga “Tirania e robërisë” me katër vargje kuitesenciale poetike, që i bën një prerje prolog apo “uverturë” të historisë sonë kombëtare me një gjuhë poetike sentencioze.

*Dy jetë korbi zgjati nata mbi tokën tonë/ Dhe galat glasishtën
njëqind vjet me radhë/ Ati ynë, sa yje këtë qiell e bëjnë të kaltër/
Dhe sa Drinër e bëjnë këtë dhë të bardhë.*

Dhe, si të ngrejë një piramidë të tiranisë së rëndë të robërisë shumëllojmëria dhe pesha e së cilës, varg pas vargu, strofë pas strofë dhe me një kreshendo të admirueshme, ia mbërrin qëllimit.

Dhe, për një arsye tjetër, pasi brenda piramidës nistore të Robërisë, në perëndimin e pashmangshëm të saj, autori ka zbuluar fillesat e një piramide tjetër himn, më të shenjtë e më universale, atë të Lirisë, për ta ngritur atë fuqishëm si bajrak i patundur për të gjithë breznitë, duke e populluar edhe me emra frymëzues të cilët do t'i marrë e rimarrë edhe në “Tiranitë” e tjera, në kontekste të tjera a në portretizime të shkëlqyera, si atë të Lirisë, Zgjimit, të Bukurisë, të Lisit etj., apo dhe duke ngritur edhe tiranitë e tjera si karakollë prej të cilave duhen ruajtur breznitë e reja të kërcënuara prej tinzaniave të pabesa, brenda dhe jashtë vetes...

Gjithashtu, ciklet brenda “Tiranive” janë jo vetëm një gjetje interesante, por dhe njëra më e bukur se tjetra, pra të një tonaliteti unik cilësor. Të bien në sy notat e mprehta humoristike e, shpeshherë sarkastike, të qëmtuara a të krijuara prej Ismail Sylës, prirja e thekshme drejt të vërtetave universale që gjenden në mençurinë popullore a në këngët e popullit tonë, çmjegullimi i sentencave të njohura apo njëfarë deheroizimi, tonet polemizuese e retoriko-aksiomatike, por dhe të shtruara siç janë përcjellë e përcillen nga brezi në brez përvojat a të vërtetat universale, duke iu kundërvënë paradokseve konceptuale të bartura a të krijuara nga gjeneratat e reja rishtazi.

“Libri i tiranive” shquan për një pasuri të madhe gjuhësore burimore gjithëkombëtare e mjetesh stilistikore poetike, çka e bën më të dashur për lexuesin.

KUJTIM DASHI

1. TIRANIA E ROBËRISË

*Dy jetë korbi zgjati nata mbi tokën tonë
Dhe galat glasitën njëqind vjet me radhë
Ati ynë, sa yje këtë qiell e bëjnë të kaltër
Dhe sa Drinër e bëjnë këtë dhé të bardhë?*

Drenicë, 20 dhjetor 2015

Tirania e dhembjes

Duke inspektuar perandorinë e ndjenjave
Kali më shpuri në kufij zonash të zhgufta*
Hapësirë e dhembjes e madhe dhe e gjerë
Sa t'i zërë gjithë refugjatët e ikur nga lufta.

Prishtinë, 6 dhjetor 2015

Streha dhe shtëpia

Në një zgurë* lisi mund të strehohet bisha
Dhe ikanaku kërkon dy tjegulla mbi kokë
Nuk më ka pëlqyer kurrë shprehja strehë
Po shtëpi, me njerëz, e me rrënjë në tokë.

Prishtinë, 5 janar 2016, ora 22:10

Epi i të shpërngulurit

(Kushtuar refugjatëve pa dallim etnie e feje)

Atë ditë kur ia ktheva shpinën shtëpisë sime
“Mirëmëngjesi” më mbet në pezul të dritares
Në drynin e derës më mbet e varur “Mirëdita”
Dhe “Puna e mbarë” te plugu në krye të arës.

Në të parën sekondë të hapit në tokën e huaj
Në varkën e Karonit ose nëpër Urën e Siraatit
Pa peshë e ngjyrë e shije, si bateria e zbrazur
Në trupin tim të vdekur, hyri shpirti i refugjatit.

Prishtinë, 6 shkurt 2016

Mashtrimi optik i Uliksit për Itakën njëzet vjet pas kthimit në Atdhe

Njëzet vjet në mendje e kish Itakën e tij
Dhjetë vjet në Trojë e po aq në bredhje
Lartësitë e mureve, vreshtat dhe ullinjë
Përrenjtë dhe luginat dhe barin në ledhe.

Ç'kishte ndodhur pas kaq vjet mungese
Veç dashuria e Penelopës e pandryshuar?
Si rrobat e pambukta, të lara gabimisht
Gjeografia e Itakës i dukej e ngushtuar.

Prishtinë, 28 dhjetor 2015

**Si e shpjegonte shakaxhiu Bajram Asllani
dallimin midis dy luftërave botërore,
fill pas kësaj të fundit**

Bajram Asllani thonë ishte nxënës shumë konkret
Në shkollën shqipe fill pas luftës së Dytë Botërore
Kur në lëndën e Bazave të Arsimit Teknik – BAT
Macen e fqinjit Rexhep e kishte sjellë si punëdore.

Në orën e historisë kish dhënë një lloj përkufizimi
Që gjenerata e tij e di dhe përsëritet prej të tjerëve
“Historia është një shkencë shoqërore që nuk merret
Me kacafytjen e maceve, po me atë midis njerëzve.”

Për të Dytën luftë, për dallim prej të Parës Botërore
Bajram Asllani kishte dhënë një përgjigje të vakët:
“Në esencë nuk dallojnë, janë identike, por e fundit
I kishte thonjtë më të mprehtë, e më të thella plagët.”

Dhjetor 2014

Gruaja shqiptare viziton burrin në burgjet jugosllave, 1945, 1950, 1968, 1981...

Me tren dhe autobus vinte loti
Në tre muaj te kthina afër pragut,
Atë e sillnin zvarrë nga qelia...
E çmallej loti me pikën e gjakut.

Prishtinë, 1 dhjetor 2014

1956

Nuk është ky kod sekret masonësh
As dhe shifër misteri e tempullarëve
Dimri i këmbëve të zbathura në borë
Në Kosovë, viti i aksionit të armëve.

Nuk është ky viti i shenjave astrale
Të kinezëve: vit i qenit, dragoit, viçit
Por i stupcit* të thyer në trup burrash
Nga policët e viteve të Rankoviqit.

Etërve tanë të gjallë dhe të vdekurve
Borë e atij dimri ua prishi tërë shtatin,
Trinat e kockave të shputës së këmbëve
Dhe shpatullat therin dhe ende narthin*...

Në Enciklopedinë Shqiptare të Vuajtjes
Nuk u shënua as dhe i vetmi paragraf
Në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe
As si krahinorizëm s'është folja narth.

Si protestë ndaj shpërfilljes, vitit 1956
I them kësaj foljeje dil dhe kundërshto
I bashkohem zgjedhimit të saj në veta
Unë ende narth... e ti, ai, ajo, ata, ato?

Prishtinë, 26 nëntor 2014

Ode për Fazli Greiçevcin

I pikoi gjaku thekëve skaj flamuri
Me temperaturën e trupit 36.8
Ia ngrohu sqetullat vetë Parajsës,
Në shkolla doktrinash bëri tërmet.

Vdekja e tij nuk qe vetëm dridhje
Për atdheun fals të socializmit
Përtej diagnozës së mjekut zyrtar
I tronditi themelet e materializmit.

E kënaqur mbet lagje e idealistëve
Vdekja e tij e rëndë idetë ua ndriti
Pa fjalë mbetën filozofët dia-matë*
Në parajsë trupi, mbi tokë shpirti.

Prishtinë, 15 dhjetor 2014, ora 20:54

1981

Nëntë tanket e nxjerra garnizonit, si bishat
Ta trembnin donin ardhjen e Pranverës
Në një korzo* të gjakut t'i kthenin bulevardet
Dhe yjet mbi Kosovë t'i hidhnin humnerës.

Dhe njësitë speciale në trupat e studentëve
Rinisë së bukur i thyenin petalet e zambakut
Snajperët tinëzisht mbi asllanët dhe naserët
Ëndrën e lirisë e lanin në shkulma të gjakut.

Mund të rishkruhen skenat e para 34 vjetësh
Me ngjyra dhe me mendime krejt bardh e zi
Po ajo që kurrë nuk ndryshon, është e kuqja
E gjakut të derdhur Pranverës tetëdhjetenjë.

Prishtinë, 18 mars 2015

Një raport i gjyqtarëve krahinorë tek autoritetet federale jugosllave

Në emër të popullit dhe të shtetit ligjor
Do ta dënojmë irredentizmin shqiptar
Me ditë, muaj e me vite të rënda burgu
Dhe me gurë shekujsh shkallë-shkallë.

Varësisht nga prurjet e rrjetës policore
Kundër peshqve i kemi sitat e guroreve:
Katërmëdhjetë deri gjashtëdhjetë gurë
KR-ja e cironkave e shkruar fletoreve.

Për ata që thërrasin “Kosova Republikë”
Në gojë u vëmë njëqind e tridhjetë e tre gurë
Për të tjerë prangosje të gjatë në errësi
Mes telave me gjemba e pa derë në mur.

Ne do e zhbëjmë nacionalizmin shqiptar
Duke e ndrydhur mes gurësh paleolitikë
E po nuk mjaftuan, i huazojmë nga koha
Shkëmbinjtë e errësirës... parahistorikë.

Prishtinë, 30 janar 2015

**Skicë për një ese për fillimin dhe fundin
e ish-Jugosllavisë me fjalët kyçe *goli otok* dhe *postbllok***

Republikës federative të vëllazërimit e bashkimit
I erdhi fundi tragjik njësoj sikur një dinozauri ulok
Midis prologut të ishullit ku të grin era mes gurësh
E epilogut të thasëve të zallit të stivuar në postbllok.

Erë Goli Otoku fryu njësoj në Nish, Srem, Idrizovë...
Historia ujem mori ngado si tagrambledhësit gjakun
Edhe lumenjve të Kosovës deri atë fillim qershori
Kur me turp robëria ikte, bashkë me zinxhirë tanku.

Prishtinë, 19 dhjetor 2014, ora 23:51

**Poezi për lisiin, me ndajfolje të përdorura
nga Adem Demaçi, andej e këndej, poshtë e përpetë...**

Lisi shtathedhur, si askush tjetër
Do të përshkruhej me rrënjë e fletë
Me ndajfoljet që i përdor Demaçi,
Andej e këndej, poshtë e përpetë.

Gjethet e luajnë vallen e erërave
Preken me degët e fqinjit të blirtë
Si bandillët ahengjeve me zonjat
Që matanë e këtë anë u bëjnë flirt.

Gjethet vjetore thahen e ndërrojnë
Si lajmi në portal që lajmin e shkul
Por trangu i lisit me rrënjë të thella
Rri pip në këmbë. Qëndron pingul.

Prishtinë, 19 tetor 2015

Malli për librat e djegur të bibliotekës sime

Shpesh po më merr malli për librat e djegur
Në verën e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetës
Si për ato fytyrat e njerëzve që i kam njohur
E para kohe i shpunë matanë perdes së jetës.

Ditën e Ringjalljes a do të jenë të radhitura
Njëjtë në bibliotekën time, ku njëra, ku tjetra,
E sërish të çmallem me shënimet në margjina
Me plot data të sakta të ditëve të mia të egra.

Prishtinë, 12 shkurt 2016

Epi për Beogradin zyrtar

Në Beogradin zyrtar me ujë të mesjetës
Ende vaditen rrënjët e luleve të urrejtjes.

Nuk mbillet ende buzëqeshja e Vlorës
E aq më pak zemërbardhësia e Kosovës.

Grykave të topave kur villet ndjesa zyrtare
Atëherë do të mbillet buzëqeshja shqiptare.

Buzëqeshja shqiptare e mbjellë në Beograd
Do të thotë mbirje lulësh edhe mbi një tank.

Më të kthjellë do rrjedhin ujërat e Valbonës.
E të rënda, ah, sa të rënda plagët e Kosovës.

Prishtinë, 15 nëntor 2014

Grafikoni i robërisë dhe ai i lirisë

Nga autobusi që na shpinte diku në greminë
Në rrugë e sipër e nëpër kthesa
Midis malit edhe fushës
Zbritëm në një
Pllajë
E
Kuptuam
Se sa e ashpër, sa e rëndë
Qe jeta e gjyshërve nëpër gërxhe
Aq e lehtë do jetë e bijve dhe e nipërve
Dhe më gjatë e stërnipërve në livadhet e paskaj.

Prishtinë, 6 nëntor 2014, në mëngjes

Ardhja e ditëve të Arbrit

Po vijnë
Ditët e Arbrit,
Po vijnë jo vetiut
Po vjen Rilindja
E Jeronim de Radës,
E Gavril Darës
Të Riut.

E që të vijnë
Fjalët u ndërthurën me tizgat*
E gjakut
Të Shotë Galicës,
Jasharëve,
Të Shabanit,
Plakut.

Prishtinë, 28 nëntor 2014

